

E DREJTA PËR INFORMIM

Konferenca VII - “Agora e Transparencës në Kohën e Integritetit”, Transparenca kusht për qeverisje të mirë dhe integrim evropian

Në përmbyllje të Javës së Integritetit 2025, u zhvillua Konferenca VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit me temë “Agora e transparencës në kohën e integritetit”. Ky aktivitet i rëndësishëm, u bashkëorganizua nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Konferenca shërbeu si një platformë kombëtare dialogu mbi sfidat e transparencës institucionale në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke vënë theksin në rolin mbikëqyrës të Komisionerit, përgjegjësinë e institucioneve publike dhe forcimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve.



Në aktivitet morën pjesë Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Edi Rama, përfaqësues të trupit diplomatik, institucioneve qendrore dhe vendore, autoriteteve të pavarura, sistemit të drejtësisë, shoqërisë civile dhe medias.

Kryeministri Rama theksoi se Shqipëria ka ndërtuar një infrastrukturë funksionale për transparencën, duke përmirësuar kapacitetet për qasje në informacion dhe duke promovuar projekte të reja si “Transparent Albania”. Ai shtoi, se vlerësimet e SIGMA-s tregojnë për funksionimin e transparencës dhe se ky projekt, synon të ofrojë të gjithë informacionin në një platformë të vetme, pa vonesa burokratike për qytetarët.

Gjatë fjalës së tij në Konferencë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, theksoi se transparenca përbën një nga shtyllat themelore të qeverisjes së mirë dhe është një element thelbësor për ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe publikut.

Ai theksoi se transparencja nuk duhet kuptuar Komisioneri Dervishi evidentoi si problematikë thjesht si publikim dokumentesh, por si një kulturë kryesore mosrespektimin e afateve ligjore për pune, e cila nxit integritetin, përgjegjshmërinë dhe kthimin e përgjigjeve, interpretimit të gabuar të llogaridhënien në çdo hallkë të administratës kufizimeve ligjore, por shpesh edhe për shkak të publike. neglizhencës.

Duke iu referuar Raportit të Komisionit Evropian Ai vuri, gjithashtu, theksin te dispozitat e për vitin 2025, Komisioneri Dervishi vuri në dukje panevojshme të konfidencialitetit, ndryshimet e se ligji “Për të drejtën e informimit” është në shpeshta të koordinatorëve apo dhe mangësitë në përputhje të gjerë me standardet evropiane, por organizimin e strukturave të brendshme zbatimi praktik i tij mbetet i paqëndrueshëm. institucionale për publikimin e informacionit të Autoritetet publike vijojnë, në jo pak raste, të përditësuar në faqet zyrtare. përdorin justifikime të përgjithshme dhe të paarsyetuara lidhur me “interesin publik” për të Në përfundim, Komisioneri Dervishi theksoi, se refuzuar kërkesat për informacion, pa respektuar zbatimi i drejtë i ligjit kërkon angazhim të parimin e proporcionalitetit dhe pa dhënë arsytim përbashkët nga autoritetet publike, shoqëria civile, të mjaftueshëm ligjor. media, bota akademike, etj.



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, deklaroi se qeveria vjen me më shumë transparencë publike, përmes portalit të transparencës.

Në fjalët e tyre, përfaqësuesit e trupit diplomatik theksuan rëndësinë e forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, ndërsa rikonfirmuan mbështetjen për Shqipërinë në procesin e integritetit, si dhe në projekte të ndryshme. Përfaqësuesit e medias dhe shoqërisë civile evidentuan problematikat dhe sfidat në lidhjen me aksesin në informacion.

Gjatë Konferencës u prezantuan 2 modelet e reja të Programit të Transparencës, të hartuara nga Zyra e Komisionerit, për autoritetet publike (qendrore dhe të varësisë, të pavarura, të sistemit të drejtësisë, universitetet, ndërmarrjet me kapital publik, etj) dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe gjetjet e Raportit vjetor të vetëdeklarimit të tyre për vitin 2024.


Po ashtu, u prezantua dhe Manuali pyetje-përgjigje për qytetarët, si një instrument praktik për rritjen e aksesit në informacion dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtën për informim.

Miratohen modelet e reja të Programeve të Transparencës, në nivel vendor: fushë e dedikuar për Këshillin Bashkiak, zbatim edhe nga Këshillat e Qarqeve

Zyra e Komisionerit miratoi dy Programet model të Transparencës për autoritetet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (LDI).

Programet model të Transparencës përbëjnë instrumente thelbësore të transparencës proaktive, duke garantuar aksesin e publikut në informacionin dhe dokumentacionin me karakter publik, duke reduktuar domosdoshmërinë për paraqitjen e kërkesave individuale për informacion dhe për të rritur nivelin e llogaridhënies institucionale të autoriteteve publike.

Vlerësimi i kuadrit ekzistues rregullator ka treguar se modelet e mëparshme kanë qenë funksionale dhe të suksesshme në organizimin e rubrikave dhe nënrubrikave të informacionit. Megjithatë, zhvillimet e mëvonshme ligjore dhe institucionale, përfshirë miratimi i Konventës nr. 205 të Këshillit të Evropës, ndryshimet ligjore në fushën e të drejtës për informim, konsolidimi i praktikave në zbatimin e LDI, si dhe përsheptimi i procesit të integritetit evropian, krijuan kushtet për modernizim dhe konsolidim të mëtejshëm të këtyre modeleve.



Programi model i Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikon përfshirjen e një fushe të re të dedikuar për veprimtarinë e Këshillit Bashkiak, si një organ i rëndësishëm i NJVV. Ky model është i zbatueshëm për këshillat e qarqeve, me qëllim forcimin e transparencës së procesit të vendimmarrjes në nivel vendor.

Miratimi i këtyre programeve model konsolidon përvojën pozitive të zbatimit të deritanishëm të transparencës proaktive, rrit përdorueshmërinë e informacionit publik dhe e shndërron transparencën në një instrument më efektiv në shërbim të qytetarëve, shoqërisë civile, medias dhe institucioneve publike.

KESHILLI BASHKIAK

Informacion rreth këshilltarëve:

1. Lista e këshilltarëve.
2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve.
3. Kontakthe të këshilltarëve nr. telefoni/ email-i zyrtar.

Informacion rreth komisioneve:

1. Përkrahimi dhe përbërja e komisioneve.
2. Njoftim për takimet e komisioneve.
3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim.
4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-aktet e diskutuara.

Kuadri rregullator i këshillit NJVV:

1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat.
2. Rregullore e funksionimit të këshillit të NJVV-së.
3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve NJVV.
4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit NJVV me publikun dhe median.
5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vlerësimeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare.

Mbledhjet e këshillit:

1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda).
2. Dokumentet për gatësim për mbledhjet.
3. Procedurat dhe vendimet pas mbledhjeve.
4. Mbledhjet live të Këshillit.

Konsultimet publike:

1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit NJVV (Emër Mbimë, telefon, adresë email).
2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit.
3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim.
4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit.
5. Përmblidhje e pas-konsultimit në raport zyrtar.
6. Raporti vjetor i transparencës së konsultimeve publike/dëgjësive publike.

Vendimet e Këshillit Bashkiak:

1. Projekt-Vendime të Këshillit NJVV.
2. Të gjitha Vendimet e NJVV (relacionet dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit).

Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit NJVV:

1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit NJVV.
2. Formular për dorëzimin e kërkesave dhe ankesave të Këshillit NJVV.
3. Formular për dorëzimin e kërkesave të Këshillit NJVV.
4. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve të Këshillit NJVV/përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar).

Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:


1. Raporti vjetor i punës së këshillit.
2. Buxheti vjetor i këshillit.
3. Raporti vjetor i konsultuar për zbatimin e buxhetit.
4. Kalendar vjetor për trajnimet.
5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë të brendshëm.
6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga OSHC-të.
7. Regjistri i peticioneve dhe iniciativave qytetare.
8. Deklaratë publike e kryetarit/ës së Këshillit për përmirësimin e transparencës.
9. Regjistri i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë.
10. Statistika

Takimi i 5-të i Komitetit Ekzekutiv të ICIC, promovimi i transparencës në arenën ndërkombëtare

Gjatë muajit dhjetor, në cilësinë e Presidencës dhe Sekretariatit të ICIC, Zyra e Komisionerit drejtoi mbledhjen e fundit për vitin 2025 të Komitetit Ekzekutiv të kësaj organizate.

Takimi u çel me fjalën përshëndetëse të Komisionerit Dervishi, i cili, në funksionin e Presidentit të Komitetit Ekzekutiv, shprehu falenderimet e sinqerta për të gjithë pjesëmarrësit, për bashkëpunimin dhe kontributin e çmuar në forcimin e rolit të ICIC për promovimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike.

Sekretariati prezantoi kalendarin e takimeve për vitin 2026, ku anëtarët e Komitetit propozuan disa ndryshime për të adresuar më mirë prioritetet dhe objektivat e organizatës.



Gjithashtu, Sekretariati paraqiti edhe një përmbledhje të diskutimeve të zhvilluara gjatë takimit të parë të Komitetit të Planifikimit, në kuadër të masave për organizimin e Konferencës së vitit 2026. U njoftua, se UNESCO do të organizojë Ditën Ndërkombëtare të të Drejtës së Informimit (IDUAI 2026) në të njëjtën periudhë kohore me punimet e Konferencës XVII të ICIC.

Gjatë kësaj mbledhje u trajtua edhe çështja e finalizimit të Raportit të Konferencës së ICIC 2025, që u mbajt me sukses në Berlin.



Bashkëpunimi me shoqatën “Together for Life”

Zyra e Komisionerit, në kuadër të bashkëpunimit me shoqatën “Together for Life”, ishte e ftuar në aktivitetin me temë *“Forcimi i demokracisë pjesëmarrëse përmes fuqizimit të shoqërisë civile”*. Takimi kishte në fokus diskutimin mbi forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal dhe qendror; përmirësimin e qeverisjes dhe shërbimeve publike në shëndetësi dhe arsim; rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në proceset vendimmarrëse; fuqizimin e shoqërisë civile në advokim të bazuar në prova dhe monitorim të politikave. Zyra e Komisionerit u përfaqësua me znj. Elona Hoxhaj, Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, e cila theksoi rëndësinë e që ka transparenca dhe përgjegjshmëria në veprimtarinë e autoriteteve publike të sektorit shëndetësor dhe atij arsimor në raport me shërbimet që u ofrohen qytetarëve.



Aktiviteti mbledhi përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, medias, të institucioneve të ndryshme qendrore dhe vendore shëndetësore dhe arsimore, etj. Takimi u zhvillua në përmblyllje të projektit *“Mbështesim pjesëmarrjen, përgjegjësinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile-SPACE”*, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga “Together for Life”, “BIRN Albania”, “Qëndresa Qytetare” dhe “Qendra për Ekselencë “Destiny”.

Po ashtu, Zyra e Komisionerit ishte e ftuar edhe në tryezën e rrumbullakët me temë *“Vizioni për një shëndetësi pa korrupsion: mekanizmat administrativë të trajtimit të ankesave”*. Në fokus të saj ishte domosdoshmëria për forcimin e praktikave të mira në luftën kundër korrupsionit në sektorin shëndetësor, për të avancuar sa më shumë transparencën, integritetin dhe ndërtimin e një sistemi më të drejtë për të gjithë.



Në takim, Zyra e Komisionerit u përfaqësua nga znj. Emerlinda Pema, Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës, e cila vlerësoi bashkëpunimin dhe ndërveprimin me organizatën “Together for Life” dhe në përgjithësi me ato të shoqërisë civile, si dhe siguroi angazhimin e institucionit për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së autoriteteve publike të këtij sektori.

Vendimmarrja e Komisionerit

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2025, ka dalë me vendimet e mëposhtme për 10 ndërmarrje publike në sektorin e shërbimeve ujësjellës-kanalizime:

Vendim nr. 45, datë 22.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat

Vendim nr. 46, datë 22.12.2025, “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë

Vendim nr. 47, datë 22.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë

Vendim nr. 49, datë 26.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër

Vendim nr. 50, datë 26.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë

Vendim nr. 51, datë 26.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë

Vendim nr. 52, datë 29.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë

Vendim nr. 53, datë 29.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës

Vendim nr. 54, datë 29.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë

Vendim nr. 55, datë 29.12.2025 “Për zbatimin e masave administrative” për autoritetin publik dhe titullarin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

